



DEMASKIMI I DYFYTYRËSISË POLITIKE NË KOSOVË

DOKUMENT PËR DISKUTIM MBI
INTEGRITETIN E PARTIVE POLITIKE



Ky projekt financohet
nga Bashkimi Evropian

DEMASKIMI I DYFYTYRËSISË POLITIKE NË KOSOVË

DOKUMENT PËR DISKUTIM MBI INTEGRITETIN E PARTIVE POLITIKE

Ky punim është i përgatitur nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), anëtare e Transparency International.

Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian.

Ky publikim është prodhuar me asistencën e Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e Institutit Demokratik të Kosovës dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si pasqyrim i pikëpamjeve të Bashkimit Evropian.



Ky projekt financohet
nga Bashkimi Evropian

COPYRIGHT © 2016. Kosova Democratic Institute (KDI).

Instituti Demokratik i Kosovës i ka të gjitha të drejtat të rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohen në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jokomerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate a materiale të ndryshme të këtij botimi, është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga do t'i ketë marrë ato citate ose materialeve që përdoren.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë:

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr. 45
10000, Prishtinë, Kosovë.
Tel.: +381 (0)38 248 038
E-mail: info@kdi-kosova.org
Web: www.kdi-kosova.org

Autor: **Visar Sutaj**
Layout & Design: **Faton Selani**

PËRMBAJTJA

HYRJE 8

RËNDËSIA POLITIKE 8

INTERESI I TI-SË 8

METODA KËRKIMORE 9

BAZA THEMELORE KËRKIMORE 9

KËRKIMET PASUESE 9

KORNIZA LIGJORE 11

DEMOKRACIA E BRENDSHME 12

BAZA E ANËTARËSISË 12

KONKURRENCA E KUFIZUAR 13

RESURSET FINANCIARE ... 14

TARIFAT E ANËTARËSISË 14

MBËSHTETJA NGA SHETI 14

KONTRIBUTET INDIVIDUALE 15

QEVERISJA E BRENDSHME 16

TRANSPARENCA PUBLIKE 16

LLOGARIDHËNIA

INSTITUCIONALE 17

PËRFAQËSIMI I INTERESAVE 18

ETIKETAT IDEOLOGJIKE 18

PATRONAZHI POLITIK 18

ZGJIDHJET PËR PROBLEMET 20

NDRYSHIMET NË LIGJ 20

NDRYSHIMI NË PRAKTIKË 20

SHTOJCAT 21

ABSTRAKTI

Në Kosovë, partitë politike kritikohen për mungesë të integritetit - që nuk respektojnë standarde konsistente morale dhe dështojnë në përfaqësimin e interesit publik. Në praktikë, partitë janë të prira të veprojnë në favor të interesit të tyre më të mirë, shpesh në kundërshtim me interesat e publikut. Ato perceptohen si agjentë të krijimit të privilegjeve të caktuara për mbështetësit nga rrethi i tyre i ngushtë. Egocentrizmi i partive politike ndoshta paraqet burimin e të gjitha problemeve të integritetit në vend. Ndërkohë që qytetarët nuk kanë informacion dhe nuk mund të sigurohen ndryshe që partitë janë duke

vepruar në emër të tyre! Ky punim përpiqet të shpjegojë se si partitë politike janë institucione të padepërtueshme dhe të papërgjegjshme dhe si duhet të reformohen ato. Punimi synon ta bëjë këtë bazuar në shqyrtimin e literaturës dhe një numër të burimeve kërkimore - ku i fundit është anketa Barometri Global i Korrupsionit (Global Corruption Barometer/GCB) lansuar nga Transparency International (TI) në nëntor 2016.

Fjalët kyçe: llogaridhënia, konkurrenca, financimi, integriteti, partitë politike, resurset, transparenca



Ky punim përpiqet të shpjegojë se si partitë politike janë institucione të padepërtueshme dhe të papërgjegjshme dhe si duhet të reformohen ato. Punimi synon ta bëjë këtë bazuar në shqyrtimin e literaturës dhe një numër të burimeve kërkimore - ku i fundit është anketa Barometri Global i Korrupsionit (Global Corruption Barometer/GCB) lansuar nga Transparency International (TI) në nëntor 2016.



HYRJE

Debati aktual mbi korrupsionin dhe si mund të luftohet ai më së miri i bën thirrje partive politike që t'i bashkohen kauzës. Nuk ka kuptim që partitë politike të kërkojnë dhe premtojnë reforma kundër-korrupsion pa bërë së pari përmirësime në veten e tyre. Kur vjen puna te rangimi i integritetit, partitë dalin më keq se institucionet ekzekutive, legjislative dhe gjyqësore, gjetje kjo e theksuar në studimin e Vlerësimit të Integritetit Kombëtar (i njohur si NIS në anglisht) botuar në tetor 2015. Studimi tregon që partitë politike nuk janë transparente dhe llogaridhënese ndaj institucioneve publike dhe publikut të gjerë.

Korrupsioni politik në Kosovë vazhdon të dëmtojë integritetin e partive politike duke shtrembëruar kështu përfaqësimin zgjedhor. Partitë shihen si agjentë të pushtetit që zhvatin ryshfet, ndikojnë në sistemin e drejtësisë dhe keqpërdorin resurset publike në dëm të interesit publik. Por pyetja është se sa kanë vullnet partitë politike për të ndryshuar kursin? A mund të iniciojnë përpjekje serioze për reforma dhe të bëhen flamurtare të përpjekjeve të kundërkorrupsionit? Nëse po, prej nga duhet të fillohet? Ky punim argumenton se duhet të fillohet me partitë politike.

Tash është koha që të zbulohet dyfytërsia politike. Zgjedhjet po vijnë dhe një numër i partive politike kanë ndryshuar tashmë udhëheqësit e tyre. Kjo është ku reforma mund të iniciohet duke i mbajtur politikanët llogaridhënës për fjalën e tyre. Betimi i Integritetit është një dokument i rëndësishëm që do t'i shërbejë agjendës së reformave (Shtojca 2). Ai përfshijë të gjitha çështjet e integritetit duke i shndërruar ato në zgjidhje dhe premtime. Ai vë vëmendjen në praktikatat e demokracisë së brendshme, transparencën financiare dhe qeverisjen institucionale, që të gjitha këto pjesë përbërëse të strukturës së këtij dokumenti.

Është e sigurt që kërkesa për reforma politike nuk është një detyrë e lehtë. Ajo është një proces afatgjatë që do të kërkojë përfshirje më të madhe të shoqërisë civile për të kërkuar që partitë politike të shndërrohen në agjentë të gjindshëm, transparentë dhe llogaridhënës. Betimi i Integritetit është një mjet simbolik që do të përdoret për ta vendosur integritetin si prioritet në hartën politike, por që do të pajisë shoqërinë civile me një armë të fortë kundër atyre që perceptohen se kanë shkelur zotimin. Në rastin ideal, ai do të shtojë trysinë pozitive dhe do të nxisë konkurrencë në mes të partive politike.

Reforma politike në fund të fundit do të kërkojë ndryshime si ligjore ashtu dhe sociale-të sjelljes, disa prej të cilave trajtohen në këtë punim. Legjislacioni aktual është tepër i gjerë në rregul-

limin e shumë prej mangësive të integritetit që kanë të bëjnë me demokracinë brenda-partiake dhe auditimin e partive politike. Por ligjet nuk kanë rëndësi të madhe në qoftë se partitë nuk e përmbledhin veten dhe nuk reformohen nga brenda. Ligjet dhe rregullat aktuale shpërfillen, në qoftë se nuk shkelen në praktikë. Për këtë arsye, është aq e rëndësishme që të përqendrohen në ndryshim për nga aspekti i qëndrimit dhe sjelljes - në mënyrë që partitë politike të përqafojnë reformën e brendshme për të mirën e tyre afatgjatë.

RËNDËSIA POLITIKE

Hyrja e Kosovës në BE varet shumë nga kriteret politike, dhe kështu, integriteti i partive politike dhe iniciativa e tyre për t'u reformuar. Merrni për shembull Greqinë, Portugalinë dhe Spanjën në vitet 1980. Nuk ishin "ekonomitë, por polititë [politika] e shteteve anëtare", që përcaktuan hyrjen e tyre në BE.¹ Atje, si në shumë vende të tjera post-komuniste, partitë politike kanë dëshmuar të jenë agjentë kryesore për reforma politike dhe institucionale.² Kosova së shpejti do të ndjekë këta hapa dhe kushtet për mënyrën se si dhe kur do t'i bashkohet BE-së do të varen nga zhvillimet e brendshme të partive politike.

INTERESI I TI-SË

Transparency International (TI) është e idesë se duke rregulluar dhe ekspozuar rrjedhat e parave brenda dhe jashtë partive politike, qytetarët mund të presin një sistem politik më të drejtë, më transparent dhe më llogaridhënës. TI-ja ndihmon Partnerët e vet të Degëve në Ballkanin Perëndimor për të kryer avokim të shënjestruar, me qëllim të reformimit të rregulloreve dhe përmirësimit të zbatimit të kornizës ligjore. Nëpërmjet këtyre reformave, TI-ja shpreson të shohë klasat politike të bëhen më transparente dhe llogaridhënese, duke forcuar legjitimitetin dhe kredibilitetin e institucioneve demokratike në rajon.

1 Gaffney, John. Editor. Political Parties and the European Union. Routledge. 1996, f. 1.

2 Lewis, Paul G. Political Parties in Post-Communist Eastern Europe. Routledge. 2000, f. xi.

METODA KËRKIMORE

Metoda kërkimore e KDI-së përbëhet nga (i) vija themelore kërkimore e përpiluar në katër vitet e fundit më 2012-2016, dhe (ii) aktivitetet pasuese kërkimore nëpërmjet intervistave me ekspertë dhe zyrtarë në terren me qëllim të vleftësimit dhe të kuptuarit më të afërt të problemeve të integritetit dhe zgjidhjeve për këto probleme.

BAZA THEMELORE KËRKIMORE

Financimi i partive politike (2013)

KDI-ja ka publikuar një studim mbi financimin e partive politike në qershor 2013. Ky studim paraqet një përmbledhje të aktiviteteve financiare të partive politike të shpenzuara gjatë zgjedhjeve të vitit 2010. KDI ka kryer një rishikim tërësor të legjislacionit që ka të bëjë me transparencën e partive politike dhe deri në çfarë mase është ndjekur në praktikë. Informatat e mbledhura gjatë kërkimit janë përdorur për të krijuar një Indeks të Transparencës për financimin e partive politike.

Gjetjet kërkimore tregojnë se ka një hendek të madh në mes të asaj që thonë ligjet dhe asaj që zbatohet në praktikë. Problemet apo mangësitë kryesore të indeksuara në studim përfshijnë: (a) mungesa e transparencës sa i përket bërjes publike të të dhënave financiare nga ana e partive politike dhe (b) raportet e partive politike të dorëzuara në KQZ nuk besohen dhe perceptohen si të pasakta. Ka tre vjet që KDI-ja nuk ka mundur ta kryejë një studim të ngjashëm për financimin e partive politike. Kjo për shkak të mungesës së qasjes në informatat financiare të partive politike.

Sistemi i Integritetit Kombëtar (2015)

KDI-ja ka kryer tashmë një analizë të shkurtër të partive politike, si pjesë e një studimi më të gjerë kërkimor të Sistemit të Integritetit Kombëtar (NIS) të publikuar në fund të 2015. Gjetjet e NIS-it tregojnë se partitë politike janë shkaku rrënjor për të gjitha problemet e integritetit në Kosovë. Nga pikëpamja e NIS-it, partitë politike nuk janë kompetente, transparente dhe llogaridhënëse në përfaqësimin e interesit publik.

Në këtë punim, KDI-ja bën një hap më tej për të arsyetuar më thellë se pse hipoteza e NIS-it është e vërtetë. Ajo argumenton se partitë politike në një masë të madhe janë institucione të pandershme dhe jodemokratike. Ky është një tipar që ata e përhapin në tri degët e pushtetit (legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor). Kjo lidhje i ngjan një logjike metaforike domino, që thotë se në qoftë se partitë politike nuk kanë integritet, institucionet të cilat ato qeverisin (d.m.th. ekzekutivi) dhe përpiqen të ndikojnë (d.m.th. gjyqësori) do të ndjekin shembullin e tyre.

Përveç të dhënave cilësore të marra nga intervistat, KDI-ja ka inkuar edhe një numër të testeve në terren për të matur transparencën e institucioneve publike. KQZ-ja është renditur në pozitën më të ulët sa i përket transparencës. Ky institucion është shumë i politizuar duke pasur anëtarë në bordin vendim-marrës të cilët emërohen drejtpërdrejt nga partitë politike. Së fundi, sipas premisë logjike të NIS-it, në qoftë se partitë kanë dorë në ndonjë institucion, ka më pak të ngjarë që institucioni i tillë do të kryejë mirë punën e vet dhe të bëhet më transparent dhe llogaridhënëse.

KËRKIMET PASUESE

Intervistat dhe burimet

Ky dokument kryesisht mbështetet në të dhëna që rrjedhin nga një numër i intervistave me ekspertë dhe zyrtarë dhe të dhëna të marra nga burime vendore dhe ndërkombëtare të formësuara sipas pyetësorit të hartuar nga Transparency International (TI). Për qëllime të referimit ndaj më shumë burimeve të bazuara në dëshmi, KDI-ja konsultuar një numër të ngushtë të ekspertëve dhe zyrtarëve të përfshirë në punë të zgjedhjeve dhe zhvillim partiak. Për qëllime të objektivitetit, nuk është intervistuar asnjë zyrtar nga partitë politike. Intervistat u vunë në kornizë të një formati të veçantë me qëllim që të kuptohet se pse ka rritje të pakënaqësisë publike me institucionet publike dhe ku bie kjo në kuptim të partive politike.

Gjatë këtij viti, KDI-ja u përpoq për të kuptuar më thellësisht çështjet kryesore në lidhje me integritetin e partive politike. Pyetjet kryesore të parashtruara gjatë kërkimit ishin si më poshtë: (1) sa partitë politike varen nga fondet private dhe publike, (2) pse partitë politike nuk janë të hapura sa i përket aktiviteteve të tyre financiare dhe administrative, dhe (3) pse partitë politike nuk janë

llogaridhënese ndaj anëtarëve dhe zgjedhësve të tyre. Qasja ndaj parashtrimit të këtyre pyetjeve dhe nën-pyetjeve pasuese përbëhej nga analiza ligjore e legjislacionit aktual dhe vlerësimi i thellë i asaj se në çfarë mase zbatohen ligjet në praktikë.

të mëdha në vendin e tyre nga një listë çështjesh të tjera, duke filluar nga ekonomia, papunësia dhe krimi deri te emigracioni, shëndetësia dhe arsimi. Në këtë kuptim, dy të tretat e qytetarëve në këto vende mendojnë se korrupsioni duhet të jetë prioritet për trajtim nga qeveria (65 deri në 67 për qind nga 100 për qind).

Barometri i korrupsionit


Transparency International (TI) ka nisur anketën e Barometrit Global të Korrupsionit. TI-ja foli me rreth 60,000 qytetarë në 42 vende në Evropë dhe Azinë Qendrore mbi gjendjen aktuale të sektorit publik. Anketa është kryer ballë për ballë duke përdorur qasjen e intervistimit personal me ndihmë të kompjuterit (CAP) nga dhjetori 2015 deri në mars 2016. Mostra është shpërndarë në të gjithë rajonet e vendit në përpjesëtim me madhësinë e popullsisë. Respondentët u përzgjedhën në mënyrë të rastësishme nga të gjithë anëtarët madhorë të familjes së tyre. Mostra është peshuar të jetë përfaqësuese në nivel kombëtar. Është bërë çdo përpjekje për të siguruar informacion të saktë.

Në Kosovë, madhësia e mostrës ishte 1,500 të anketuar të moshës 18 vjeç dhe më të vjetër duke mbuluar zonat urbane dhe rurale. Kosova shënon rezultatet më të larta kur është fjala për mendimin se korrupsioni është si një nga problemet kryesore me të cilat përballet vendi. Spanja dhe Moldavia bien nën të njëjtën kategori të vlerësimit të korrupsionit si një nga tri problemet më

Por sa e gatshme është qeveria për të trajtuar korrupsionin si prioritet është e pak e besueshme. GCB-ja gjithashtu tregon për perceptimin e korrupsionit sipas institucioneve. Përshtatshmërisht, perceptimi i korrupsionit është më i ulëti për institucionet qeveritare dhe të kuvendit. Figura e mëposhtme tregon se përqindja e të anketuarve që mendojnë se shumica apo të gjithë zyrtarët qeveritarë dhe deputetët janë të korruptuar arrin 46 për qind. Nivelet e larta të mosbesimit mund të lidhen me ndikimin gjithnjë e më negativ të partive politike në institucionet që ata përfaqësojnë.

Mungesa e integritetit në partitë politike ia hapë rrugën korrupsionit dhe kjo mund të ndikojë negativisht në besimin në institucionet publike. Të dhënat e GCB-së nuk mund të arsyetojnë këtë lidhje pasi janë përqendruar më shumë në institucionet publike, dhe partitë politike nuk janë pjesë e anketës. Por nëpërmjet përdorimit të këtyre të dhënave, si prova në një argument koherent i qëndrimit të punimit, KDI-ja do t'i japë punës së saj shanset më të mira për të pasur ndikim në debatin politik. GCB-ja duhet të shihet më shumë si një parametër për partitë politike që të njohin dhe miratojnë publikisht reformën.

FIGURA 1:
PERCEPTIMI I KORRUPSIONIT,
SIPAS INSTITUCIONIT – PËRQINDJA QË MENDON
SE SHUMICA APO TË GJITHË JANË TË KORRUPTUAR



Baza. Të gjithë respondentët

KORNIZA LIGJORE

Legjislacioni aktual është i gjerë në aspektin e rregullimit të funksionimit të partive politike. Kushtetuta dhe ligjet zgjedhore japin diskrecion të përgjithshëm për zbatimin e rregullave dhe rregulloreve. Kushtetuta garanton të drejtën për të themeluar një organizatë (Neni 44) dhe të drejtën e çdo qytetari që ka arritur moshën 18 vjeç për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur (Neni 45).

Ligjet kryesore që rregullojnë partitë politike janë Ligji për Zgjedhjet e përgjithshme dhe Lokale dhe Ligji për Financimin e Subjekteve Politike. Megjithatë, në këto ligje, mungojnë dispozita të caktuara për rregullimin e qeverisjes së brendshme dhe transparencën financiare të cilat potencialisht mund të trajtohen përmes një reforme të plotë ligjore. Për më shumë hollësi mbi atë se cilat dispozita specifike duhet të ndryshohen, referojuni tekstit në paragrafët në vijim.

Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme përcakton përgjegjësitë dhe funksionimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.³ KQZ-ja mban përgjegjëse Zyrën për Regjistrim të Partive Politike dhe Certifikim ("Zyra") për mirëmbajtjen e regjistrit të partive politike, kufizimin e shpenzimeve të fushatave dhe deklarimin financiar.⁴ Ligji për Financimin e Subjekteve Politike rregullon mënyrën, kushtet e financimit, administrimin, mbikëqyrjen dhe raportimin mbi të ardhurat e partive politike dhe gjithashtu parasheh transparencë të shtuar dhe raportimin e shpenzimeve.⁵

3 Gazeta Zyrtare. Ligji Nr. 03/L-73 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës. 15 qershor 2008. Neni 1, par. 1.

4 Gazeta Zyrtare. Ligji Nr. 03/L-73 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës. 15 qershor 2008. Neni 11, par. 9.

5 Gazeta Zyrtare. Ligji Nr. 03/L-174 për Financimin e Subjekteve Politike. 21 tetor 2010. Neni 1, par. 1.



Ligjet kryesore që rregullojnë partitë politike janë Ligji për Zgjedhjet e përgjithshme dhe Lokale dhe Ligji për Financimin e Subjekteve Politike. Megjithatë, në këto ligje, mungojnë dispozita të caktuara për rregullimin e qeverisjes së brendshme dhe transparencën financiare të cilat potencialisht mund të trajtohen përmes një reforme të plotë ligjore. Për më shumë hollësi mbi atë se cilat dispozita specifike duhet të ndryshohen, referojuni tekstit në paragrafët në vijim.



KONKURRENCA E KUFIZUAR

Tranzicioni nga sistemi pas-socialist dhe një-partiak nuk çoi në një “jetë të mirëfilltë politike pluraliste e demokratike.”⁸ Karakteristika kryesore e sistemit një-partiak siç përkufizohet nga Hofmeister dhe Grabow është “shtypja e konkurrencës politike dhe lirisë demokratike.”⁹ Në Kosovë, në pesëmbëdhjetë vitet e fundit ka qenë sfidë për partitë politike për të njohur dhe miratuar praktikën e konkurrencës dhe demokracisë brenda partiake. Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave përmbledh arsyet kryesore prapa asaj se pse liderët nuk kanë treguar ndonjë dëshirë për reforma.¹⁰

Në përgjithësi, partitë politike janë të mbi-centralizuara. Komiteti ekzekutiv është autoriteti fundor për marrjen e vendimeve të cilat zakonisht pranohen në të gjitha nivelet e partisë. Komitetet janë shumë të afërta me liderët e partive, pasi që liderët e partive bëjnë emërimin e anëtarëve të Komitetit. Kjo e bën të pamundur largimin e liderëve të fortë ose madje daljen

në konkurrim të liderëve të rinj. Në katër vitet e fundit ka pasur ndryshime në udhëheqje. Por këto ndryshime duken margjinale dhe afatshkurtra dhe nuk rezultojnë me reforma konkrete.

Procesi i zgjedhjes së udhëheqësve zakonisht kryhet me aklamacion, një proces zgjedhor ky i administruar nëpërmjet shprehjes së hapur të miratimit për një kandidat të caktuar. Kjo formë e zgjedhjeve praktikohet në shumë demokraci moderne. Por, luan rol ajo se si dhe në cilin kontekst përdoret aklamacioni. Në rastin e Kosovës, ky proces është jodemokratik - aq më tepër në mesin e partive politike në pushtet. Të dyja partitë e koalicionit zgjedhin me aklamacion një të vetëm prijës të tyre pa pasur ndonjë zgjedhje tjetër. Nuk organizohen zgjedhjet për kandidatët partiakë, të cilat potencialisht do të ngushtonin fushën e kandidatëve para zgjedhjeve.

Dispozitat themelore ligjore ekzistojnë, por më shumë mund të ndryshohet duke kërkuar nga partitë politike që të veprojnë në përputhje me procedurat e brendshme demokratike. Pengesat aktuale të demokracisë së brendshme rrjedhin nga lidhshipi dominues dhe konkurrenca jo e shëndoshë. Partitë politike duhet të përqendrohen si në rezultatet zgjedhore ashtu dhe në transformimin e brendshëm, që në fund të fundit kërkon që vendimmarrja e tyre të jetë shumë më gjithëpërfshirëse duke dhënë mundësi të shtuara për zgjedhjen e udhëheqësve të rinj.

8 Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave (KIPRED). Sistemi zgjedhor dhe partiak në Kosovë. 2015, f. 29.

9 Hofmeister, Wilhelm & Karsten Grabow. Political Parties. Konrad Adenauer Stiftung. 2011

10 Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave (KIPRED). Sistemi zgjedhor dhe partiak në Kosovë. 2015, f. 37

Partitë politike duhet të përqendrohen si në rezultatet zgjedhore ashtu dhe në transformimin e brendshëm, që në fund të fundit kërkon që vendimmarrja e tyre të jetë shumë më gjithëpërfshirëse duke dhënë mundësi të shtuara për zgjedhjen e udhëheqësve të rinj.

RESURSET FINANCIARE

Autonomia e partive politike nga subjektet shtetërore dhe të korporatave është një masë e rëndësishme e fuqisë institucionale. Varësia në rritje e mbështetjes nga shteti tregon se sa të brishta janë partitë politike në praktikë. Prania e komunitetit të korporatave që vepron si një 'sponsor' i partisë është gjithashtu tregues negativ sidomos nëse nuk ka transparencë. Është e vështirë për të nxjerrë një analizë të besueshme të dallimit midis fondeve shtetërore dhe kontributeve të tjera, sepse nuk raportohet çdo gjë, në veçanti kur është fjala për kontributet në natyrë dhe financimin privat.

Çështja nëse kontributet shtetërore kundrejt atyre individuale janë më të mira apo më të këqija është temë për një tjetër dokument për diskutim. KQZ-ja luan rol të rëndësishëm në ndalimin e ndërhyrjeve në rrethana të tilla. Por, në këtë drejtim del një pengesë e rëndësishme. Me ligj, KQZ-ja është një institucion politik i përbërë nga anëtarë që përfaqësojnë partitë politike. Përveç kësaj, asaj i mungojnë resurset njerëzore dhe financiare për të garantuar pajtueshmërinë financiare të partive politike. Kjo e bën të lehtë për partitë që të fitojnë kontroll të rëndësishëm dhe jo-demokratik të pushtetit publik, "duke vepruar si agjenci të shtetit dhe duke u degjeneruar në oligarki të vetë-përrjetësuar."¹¹

Ligji për Financimin e Subjekteve Politike rregullon mënyrën, kushtet e financimit, administrimin, mbikëqyrjen dhe raportimin mbi të ardhurat e partive politike dhe gjithashtu parasheh transparencë të shtuar dhe raportimin e shpenzimeve.¹² Resurset financiare dhe materiale të partive politike varen nga mbështetja financiare shtetërore, tarifat e anëtarësisë dhe kontributet individuale.¹³

TARIFAT E ANËTARËSISË

Baza e anëtarësisë dhe forca e saj në formimin e vendim-marrjes së brendshme është një element i rëndësishëm në zhvillimin e partisë. Megjithatë, partitë në Kosovë nuk kanë anëtarësi të madhe dhe besnike. Elitizmi dhe strukturimi lart-poshtë i partive politike përcakton kufijtë për zgjerimin e anëtarësisë.¹⁴ Elita politike është ajo që mban frenat e partive politike. Roli i parëndë-

sishëm i anëtarësisë, i kombinuar me ndikimin dominues të ushtruar nga liderët e partive, minon fuqinë e partive politike dhe dëmton bazën e elektoratit.¹⁵ Nëse analizohen raportet financiare të vitit 2011 dhe 2012, tarifat e anëtarësisë përbëjnë jo më shumë se një për qind të buxhetit të përgjithshëm për secilin vit raportues.¹⁶ Këto janë raportet financiare të parashtruara në Komisionin Zgjedhor dhe janë në dispozicion në internet. Duket se anëtarësia nuk perceptohet si një dinamikë e rëndësishme në vend. Për shembull, detyrimet e anëtarësisë nuk paguhen gjithmonë dhe dështimi për ta bërë këtë medoemos nuk çon në largimin e anëtarit nga partia. Kjo është një veti e zakonshme në shumë vende pas-komuniste në Evropën Lindore.¹⁷ KDI-ja ka bërë përpjekje për të marrë të dhëna rreth anëtarësisë nga katër partitë kryesore politike. Mirëpo, nuk ka marrë asnjë përgjigje, me përjashtim të Lëvizjes Vetë-Vendosje. Sipas ekspertit vendor të zgjedhjeve nga Fondacioni Ndërkombëtar për Sistemet Zgjedhore (IFES), Yll Buleshkaj, partitë nuk i kushtojnë vëmendje bazës së të dhënave të anëtarësisë së tyre për atë se kush është anëtar i regjistruar dhe kush ka interesim që të bëhet anëtar.¹⁸ Baza e të dhënave do të shërbente si mjet i fuqishëm për ngritje të fondeve, si dhe për qëllime të fushatave zgjedhore. Në të vërtetë, kjo është diçka që kërkohet nga Komisioni Zgjedhor për krijimin dhe mbajtjen e një regjistri të anëtarësisë.

MBËSHTETJA NGA SHTETI

Është e rëndësishme që të analizohen marrëdhëniet e partive politike me shtetin dhe varësia e tyre në rritje e sipër nga resurset shtetërore për të mbijetuar. Kuota e financimit nga shteti është dyfishuar që nga viti 2012. Më parë, lypsej që shteti të shpenzojë jo më shumë se 0.17 për qind të buxhetit të vet për financimin e subjekteve politike.¹⁹ Sot kjo kuota ka arritur në 0.34 për qind të buxhetit të shtetit.²⁰ Financimi alokohet në bazë të numrit të vendeve në Kuvend. Ai shfrytëzohet për financimin e aktiviteteve parazgjedhore e zgjedhore, grupeve punuese të Kuvendit dhe aktiviteteve të rregullta të subjekteve politike.²¹

11 Pope, Jeremy. *Confronting Corruption: The Elements of a National Integrity System*. TI. 2000, f. 50.

12 Gazeta Zyrtare. Ligji Nr. 03/L-174 për Financimin e Subjekteve Politike. 21 tetor 2010. Neni 1, par. 1.

13 Gazeta Zyrtare. Ligji Nr. 03/L-174 për Financimin e Subjekteve Politike. 21 tetor 2010. Neni 4, par. 2.

14 Lewis, Paul G. *Political Parties in Post-Communist Eastern Europe*. Routledge. 2000, f. 95.

15 Lewis, Paul G. *Political Parties in Post-Communist Eastern Europe*. Routledge. 2000, f. 95.

16 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. *Raportet Financiare dhe Auditimet*. [Qasur më 30 tetor 2016].

17 Lewis, Paul G. *Political Parties in Post-Communist Eastern Europe*. Routledge. 2000, f. 98.

18 Buleshkaj, Yll. IFES. Intervistë. 14 tetor 2016.

19 Gazeta Zyrtare. Ligji Nr. 03/L-174 për Financimin e Subjekteve Politike. 21 tetor 2010. Neni 7, par. 3.

20 Gazeta Zyrtare. Ligji Nr. 04/L-058 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 për Financimin e Subjekteve Politike. Janar 2012. Neni 2, par. 1.

21 Gazeta Zyrtare. Ligji Nr. 03/L-174 për Financimin e Subjekteve Politike. 21 tetor 2010. Neni 10, par. 3.

Në vitin 2015, shteti financoi partitë politike në vlerë prej gjithsej 4,200,000 Euro.²²

Sa i përket shpenzimeve të fushatës, nga shteti kërkohet që të alokojë jo më shumë se 0.05 për qind të buxhetit publik për zgjedhje të rregullta dhe të jashtëzakonshme.²³ KQZ-ja përcakton "maksimumin e shpenzimeve të fushatës mbështetur në numrin e përgjithshëm të votuesve të regjistruar në listën e votuesve në kohën e freskimit të fundit të listës së votuesve në dispozicion të KQZ-së."²⁴ Kufiri i financimit i vendosur nga KQZ-ja, në përputhje me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Zgjedhjet Lokale dhe Rregulloren Nr. 12/2013, vjen në 50 cent për votues në komuna. Financimi i përgjithshëm për fushatë nga shteti për zgjedhjet lokale në vitin 2013 arriti në 886,860 Euro.²⁵ Për zgjedhjet kombëtare në vitin 2014, shuma totale ishte 893,463 Euro.²⁶


KONTRIBUTET INDIVIDUALE

Partitë politike gjithashtu varen nga kontributet individuale. Kufizimet në kontributet vjetore janë vendosur nëpërmjet dy kanaleve (i) për personat fizikë shuma nuk duhet të tejkalojë 2,000 Euro, dhe (ii) për personat juridikë shuma nuk duhet të tejkalojë 10,000 Euro.²⁷ Kërkohet me Ligj që këto burime të vërtetohen nga një autoritet kompetent. Nëse origjina e burimit nuk mund të vërtetohet, shuma do të mbetet në buxhetin e shtetit.²⁸ Organizatat jofitimprurëse i ndalohet rreptësisht të mbështetja e partive politike në bazë të Ligjit për Lirinë e Asociimit në Organizatat Jo-Qeveritare (OJQ).²⁹

Burimi më i diskutueshëm i financimit të partive politike janë kontributet individuale (donacionet) qoftë për shkak të tejkalimit të kufizimeve apo për shkak të financimit në mënyrë të paligjshme. Sipas Barometrit Global të Korrupsionit (GCB), 46 për qind e të anketuarve u pajtuan se mbështetja financiare nga kompanitë për partitë politike dhe kandidatët duhet të ndalohet. Shih Figurën 2 më poshtë.

Partitë marrin shumë fonde që nuk raportohen dhe kjo është shumë e rrezikshme pasi që grupet e veçanta të interesit mund të ushtrojnë ndikim mbi partitë politike në kundërshtim me parimet themelore të demokracisë. Kjo është arsyeja pse janë

FIGURA 2: PËRQINDJA QË PAJTOHET SE "MBËSHTETJA FINANCIARE PËR PARTITË POLITIKE DHE KANDIDATËT NGA KOMPANITË DUHET TË NDALOHET PLOTËSISHT.



aplikuar ndalime shtesë për ndihmën financiare në Ligjin e ri për Financimin e Partive Politike. Këto përfshijnë kompanitë që janë në marrëdhënie kontraktuese me institucionet publike ose kanë qenë në tre vitet e fundit, OJQ-të, organizatat bamirëse, organizatat fetare, sindikatat, dhe kështu me radhë.

“Korrupsioni në financimin e partive politike, jo vetëm që minon proceset demokratike dhe ekonominë e një vendi, por edhe ato të të gjithë Bashkimit Evropian (BE)..

Transparency International (TI)

Në demokracitë e brishta, partitë politike janë të prira të lulëzojnë me financim të paligjshëm. Ligjet e pamjaftueshme për financimin politik mund të çojnë në rreziqe serioze të korrupsionit. Nuk ka asnjë institucion përgjegjës për verifikimin e burimeve dhe për t'i mbajtur partitë llogaridhënëse. KQZ-ja nuk është e autorizuar për të verifikuar saktësinë e shpenzimeve të cilat partitë i pësojnë gjatë dhe pas zgjedhjeve. Prandaj, ka kontrolle të dobëta në rregullimin e financimit dhe aktiviteteteve të lobimit të partive, pasi që Zyra nuk ka resurse ligjore dhe njerëzore për të bërë punën e saj. Raportet e auditimit nga 2011-2012 tregojnë se partitë politike shkelin ligjet, ndërsa gjambat e shqiptuara nga Komisioni Zgjedhor nuk janë të larta. Besnik Boletini, nga ÇOHU, i referohet fondeve që vijnë nga jashtë,³⁰ në të cilën rast nga partitë kërkohet që t'ia kthejnë këto kontribute donatorëve. Prandaj, korrupsioni në financimin e partive shtrembëron sjelljen e politikanëve kudo në rajon. Kufizimet janë rritur në shumë vende evropiane, duke vendosur pragje të ulëta. Jo vetëm që janë tkurrur kufijtë, në shumë vende donacionet e korporatave janë ndaluar krejtësisht.³¹

22 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ). Kërkesë për informacion. 2 nëntor 2016.

23 Gazeta Zyrtare. Ligji Nr. 03/L-174 për Financimin e Subjekteve Politike. 21 tetor 2010. Neni 10, par. 3.

24 Gazeta Zyrtare. Ligji Nr. 03/L-73 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës. 15 qershor 2008. Neni 39, par. 21.

25 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ). Kërkesë për informacion. 2 nëntor 2016.

26 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ). Kërkesë për informacion. 2 nëntor 2016.

27 Gazeta Zyrtare. Ligji Nr. 03/L-174 për Financimin e Subjekteve Politike. 21 tetor 2010. Neni 5, par. 2.

28 Gazeta Zyrtare. Ligji Nr. 03/L-174 për Financimin e Subjekteve Politike. 21 tetor 2010. Neni 5, par. 2.

29 Gazeta Zyrtare. Ligji Nr. 04/L-057 për Lirinë e Asociimit në Organizatat Jo-Qeveritare. 9 shtator 2011. Neni 15, par. 7.

30 Boletini, Besnik. ÇOHU. Intervistë. 26 gusht 2016. 14 tetor 2016.

31 Transparency International (TI). Money, Politics, Power: Corruption Risks in Europe. Regional Policy Paper #2. 2012, f. 3.

QEVERISJA E BRENDSHME

Qeverisja institucionale e partive politike është e rregulluar në bazë të Ligjit për Zgjedhjet dhe Ligjit për Financimin e Partive Politike. Legjislacioni aktual nuk përfshin shumë dispozita ligjore, dhe përmban zbrazëti specifike që kanë të bëjnë me transparencën dhe llogaridhënien e partive politike. Më e rëndësishmja, nuk ka një ligj të unifikuar dhe të veçantë për partitë politike i cili do të adresonte mospërputhjet ligjore. Vendosja e rregullave sa i përket qeverisjes së brendshme i është lënë në diskrecion Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ).

TRANSPARENCA PUBLIKE

Pasqyrat financiare të partive politike duhet të auditohen çdo vit në përputhje me dispozitat e përcaktuara në legjislacion. Partitë duhet t'ia parashtrorin Komisionit raportet vjetore financiare për vitin e kaluar më së voni deri më 1 mars,³² pas kësaj Komisioni duhet t'i publikojë ato së bashku me raportet e audituara në uebsajtin e vet.³³ KQZ-ja ishte përgjegjëse për auditimin e raporteve financiare deri në vitin 2013, kur kjo përgjegjësi ka kaluar në Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike të Kuvendit të Kosovës.³⁴ Që atëherë, nuk janë kryer auditime, dhe deri më sot, nuk ka raporte financiare të partive politike që janë vënë në dispozicion të publikut (me përjashtim të [Lëvizjes Vetëvendosje](#)).

Dispozitat e reja në Ligjin për Financimin e Partive Politike parashohin që Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike duhet të zgjedhë auditorë të pavarur për të kryer auditimin e raporteve të deklarimit financiar të fushatës të parashtruar në KQZ nga partitë politike.³⁵ Përkundër faktit se të gjitha raportet për tre vitet e fundit janë parashtruar, Komisioni nuk ka inicuar auditimin e partive politike. Komisioni Evropian (KE) në Raportin e fundit të Progresit (2015) ka bërë thirrje për auditim të partive politike.³⁶ Megjithatë, partitë nuk duken të brengosura në lidhje me këtë çështje për arsye të paditura me siguri ndonëse kjo i bën ata

të që të mos u zihet besë dhe që nuk e meritojnë besimin e publikut.

Asgjë në këtë ligj nuk i parandalon partitë politike nga publikimi i raporteve të tyre financiare në uebsajtin e tyre. Në fakt, legjislacioni aktual kërkon që ato të publikojnë dhe të bëjnë publike raportet e tyre vjetore financiare dhe raportet e deklarimit të kontributeve për fushatë në uebsajtin e tyre.³⁷ Në të kundërtën, ato do të gjobiten me dhjetë për qind të shumës së realizuar nga fondet shtetërore në vitin e kaluar dhe një gjobë ditore prej 0.01 për qind të shumës së gjobës bazë derisa të paraqitet raporti.³⁸ Deri më tani, nuk ka dënime të shqiptuara ndaj partive për shkak se nuk kanë bërë publike raportet financiare në uebsajt.

Dhe as nuk e pengon Komisionin për t'i vënë ato në dispozicion të publikut. Arsyetimi i tij që raportet financiare duhet fillimisht të auditohen para se të publikohen nuk është legjitim. Atij i mungon siguria ligjore pasi që ligjet dhe rregulloret në mënyrë specifike nuk tregojnë se raportet duhet të kenë vulën e auditimit në mënyrë që të publikohen. Legjislacioni vetëm thotë se KQZ-ja duhet të publikojë raportet financiare edhe ato të auditimit të partive politike në uebsajtin e saj zyrtar jo më vonë se 30 qershor.³⁹ KDI-ja nuk ka marrë një përgjigje të qartë nga Komisioni se pse raportet financiare të partive politike mbahen ende të mbyllura dhe nuk ndahen me publikun.

Ndërkohë, publiku mbahet në terr pa asnjë qasje në informatat financiare, në mënyrë të veçantë në Dosjen e Informimit Publik (DIP). Dosja përbëhet nga dokumentet kryesore, duke përfshirë regjistrin e donatorëve dhe raportet financiare të fushatës,⁴⁰ që sipas legjislacionit, duhet të jenë në dispozicion nga KQZ-ja gjatë orarit të rregullt të punës ose nëpërmjet uebsajtit.⁴¹ Sa financim marrin partitë politike dhe nga kush është informacioni i rëndësishëm për shoqërinë civile për ta marrë në çdo kohë. Dosja e fundit e publikuar në uebsajt është e vitit 2010.⁴²

32 Gazeta Zyrtare. Ligji Nr. 03/L-174 për Financimin e Subjekteve Politike. 21 tetor 2010. Neni 15, par. 4.

33 Gazeta Zyrtare. Ligji Nr. 03/L-174 për Financimin e Subjekteve Politike. 21 tetor 2010. Neni 16, par. 5.

34 Gazeta Zyrtare. Ligji Nr. 03/L-174 për Financimin e Subjekteve Politike. 21 tetor 2010. Neni 19, par. 6.

35 Gazeta Zyrtare. Ligji Nr. 04/L-212 për Plotësimin dhe Ndryshimin e ligjit Nr. 03/L-174 për Financimin e Subjekteve Politike, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-058. Gusht 2013. Neni 19, p. 4.

36 Komisioni Evropian (KE). Dokument pune i stafit të Komisionit. Raporti për Kosovën 2015. Bruksel. Nëntor 2015, f. 6.

37 Gazeta Zyrtare. Ligji Nr. 04/L-212 për Plotësimin dhe Ndryshimin e ligjit Nr. 03/L-174 për Financimin e Subjekteve Politike, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-058. Gusht 2013. Neni 8, par. 3.

38 Gazeta Zyrtare. Ligji Nr. 04/L-212 për Plotësimin dhe Ndryshimin e ligjit Nr. 03/L-174 për Financimin e Subjekteve Politike, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-058. Gusht 2013. Neni 21, par. 5.

39 Gazeta Zyrtare. Ligji Nr. 04/L-212 për Plotësimin dhe Ndryshimin e ligjit Nr. 03/L-174 për Financimin e Subjekteve Politike, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-058. Gusht 2013. Neni 19, par. 5.

40 Gazeta Zyrtare. Ligji Nr. 03/L-73 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës. 15 qershor 2008. Neni 43, par. 23.

41 Gazeta Zyrtare. Ligji Nr. 03/L-73 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës. 15 qershor 2008. Neni 43, par. 23.

42 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Dosja e Informimit Publik. [Qasur më 5 nëntor 2016].

Mungesa e qasjes në informata financiare bëhet një problem më serioz kur bëhet fjalë për shpenzimet e fushatës. Shfrytëzimi i një auditori të jashtëm apo auditori të fushatës, për auditimin e raporteve financiare të fushatës mund të bëhet me vendim nga KQZ-ja, Zyra për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim ("Zyra").⁴³ Për fat të keq, Zyrës i mungojnë resurset njerëzore dhe financiare për të kryer auditime hetimore gjatë sezonës së fushatës. Shumë jokonsistenca të shpenzimeve janë zbuluar nga shoqëria civile, të cilat Zyra nuk ka mundur t'i raportojë. Ato i referohen mospërputhjeve në mes të asaj që raportohet nga partitë politike dhe asaj që shpenzohet.

Publiku meriton të ketë qasje të plotë dhe të përditësuar në të gjitha informatat financiare të partive politike, pavarësisht hapësirave ligjore në interpretim. Nuk ka gjasë që raportet financiare të dorëzuara tashmë pranë Komisionit do të ndryshojnë nga raportet përfundimtare të audituara të cilat botohen. Gjithashtu, nuk është se auditorët do të inspektojnë dhe raportojnë në hollësi të mëdha për llogaritë financiare të partive politike. Raportet e auditimit të jashtëm janë shumë të gjerë dhe përbëhen nga një opinion i përgjithshëm i një auditori të pavarur nëse pasqyrat financiare të partisë janë pa keq-deklarime materiale.

Kjo jokonsistencë ligjore lidhur me atë nëse raportet financiare duhet t'i nënshtrohen auditimit në mënyrë që të publikohen duhet të adresohet. KDI-ja është e mendimit se të dy raportet nuk lidhen me njëri-tjetrin kur është fjala për të bërë informacionin financiar të partive politike transparent për publikun. Ndërkohë, shkalla deri në të cilën është procesi i auditimit paraqet shqetësim serioz dhe është diçka që nuk guxon të përsëritet në të ardhmen. KE-ja në Raportin e Progresit të këtij viti (2016) ka bërë thirrje që partitë politike të përfshihen në një debat institucional se si të rritet transparencja dhe llogaridhënia për financimin e partive dhe kontributet e fushatës.⁴⁴

Nuk ka asnjë dispozitë ligjore në legjisllacion që pengon institucionet publike që të auditojnë shpenzimet e partive politike.⁴⁵ Iniciativat për t'ia ngarkuar këtë rol Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) kanë dështuar në të kaluarën. Në prill të vitit 2016, Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike diskutoi mundësinë e politikës për auditimin e partive politike nga ZAP-i, si pjesë e Ligjit të ri për ZAP-in. Ky opsion u hodh poshtë me katër vota (nga pesë) kryesisht në bazë ligjore.⁴⁶ ZAP-i sipas Kushtetutës mund të auditojë vetëm aktivitetet ekonomike të institucioneve publike ose shtetërore, por jo subjektet private.⁴⁷ Kjo dispozitë përjashtoi të drejtën për të audituar partitë politike të cilat nuk janë subjekte shtetërore, dhe më e rëndësishmja, që marrin fonde private nga anëtarët/donatorët e tyre.

43 Gazeta Zyrtare. Ligji Nr. 03/L-73 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës. 15 qershor 2008. Neni 41, par. 22.

44 Komisioni Evropian (KE). Dokument pune i stafit të Komisionit. Raporti për Kosovën 2016. Bruksel. Nëntor 2016, f. 5.

45 Gazeta Zyrtare. Ligji Nr. 03/L-73 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës. 15 qershor 2008. Neni 41, par. 23.

46 KDI. Raporti i Monitorimit. Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike. Mbledhja e rregullt. 12 prill 2016.

47 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 137, par. 52

LLOGARIDHËNIA INSTITUCIONALE

Me ligj, partitë politike mbahen llogaridhënëse për veprimet dhe vendimet e tyre nga ana e institucioneve publike përkatëse. Llogaridhënia institucionale i referohet mekanizmave të partive politike për raportim ndaj qeverisë dhe organeve zgjedhore. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) është agjencia kryesore rregullative përgjegjëse për administrimin e zgjedhjeve dhe kontrollin e pajtueshmërisë së partive politike me rregullat që kanë të bëjnë me regjistrimin dhe financimin e partive. KQZ-ja gjithashtu i raporton Kuvendit për shpenzimet financiare të partive politike të paguara nga shteti.⁴⁸ Por, ajo nuk e ka bërë këtë për tre vitet e fundit.

KQZ-ja mban llogaridhënëse Zyrën për Regjistrim të Partive Politike dhe Certifikim apo Zyrën për mirëmbajtjen e regjistrimit të partive politike, kufizimin e shpenzimeve të fushatave dhe deklarimet financiare.⁴⁹ Kërkesat kryesore të regjistrimit përfshijnë: formularin e aplikimit, deklaratën e kodit të mirësjelljes, raportet e fundit financiare, datat e konventës më të fundit të partisë, si dhe emrat dhe adresat e së paku 500 anëtarëve të partisë që jetojnë në Kosovë.⁵⁰ Nga kritikët kryesorë, këto rregulla janë vetëm në letër dhe të një rëndësie të vogël. Shkelja e tyre nuk rezulton me sanksione të ashpra të shqiptuara nga organet zgjedhore.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) është institucion i pavarur përgjegjës për shqyrtimin e ankesave dhe parashtresave në lidhje me procesin zgjedhor.⁵¹ Të gjitha shkeljet zgjedhore mund t'i referohen PZAP-it dhe partitë politike duhet të marrin përgjegjësinë.⁵² Por, gjobat të cilat shqiptohen nga PZAP-i janë relativisht të buta, duke marrë parasysh se ato mund të shkojnë deri në 50,000 Euro. Për zgjedhjet e vitit 2014, PZAP-i ka shqiptuar gjoba në shumë të përgjithshme prej 86,700 Euro.⁵³ Në këtë rast, është e rëndësishme që të shqiptohen sanksione më të ashpra për të forcuar llogaridhënien.

48 Gazeta Zyrtare. Ligji Nr. 04/L-058 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 për Financimin e Subjekteve Politike. Janar 2012. Neni 6, par. 2.

49 Gazeta Zyrtare. Ligji Nr. 03/L-73 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës. 15 qershor 2008. Neni 11, par. 9.

50 Gazeta Zyrtare. Ligji Nr. 03/L-73 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës. 15 qershor 2008. Neni 12, par. 10.

51 Gazeta Zyrtare. Ligji Nr. 03/L-256 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, 16 nëntor 2010. Neni 1, par. 1

52 Gazeta Zyrtare. Ligji Nr. 03/L-73 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës. 15 qershor 2008. Neni 46, par. 24.

53 Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP). Rregulla Nr. 01/2012. Neni 2, par. 1.

PËRFAQËSIMI I INTERESAVE

Partitë janë të prira që të shpërfillin anëtarët e tyre në procesin e hartimit të platformave që tregojnë se partitë politike nuk janë të interesuara për të trajtuar problemet reale dhe nuk mendojnë për qëllime afatgjata. Komisionet nuk shtrijnë aktivitetin e tyre deri te grupet shoqërore për të dëgjuar shqetësimet e tyre dhe për t'iu premtuar se do t'i përfaqësojnë interesat e tyre dhe do të kujdesen për ta. Këto grupe sociale mund të shkojnë nga të rinjtë dhe gratë deri te sindikatat dhe grupet e caktuara të interesit.

ETIKETAT IDEOLOGJIKE

Partitë politike janë të prira që të paraqesin platforma tejet ambicioze dhe t'i bëjnë premtime jorealiste elektoratit të tyre. Platformat e tyre nuk bazohen në ideologji dhe qëllime afatgjata. Ato përqendrohen në prioritetet e ngutshme si rritja ekonomike dhe punësimi,⁵⁴ zakonisht gjatë sezonit të zgjedhjeve, të cilat nuk rezultojnë me masa konkrete. Platformat e partive të ndryshme politike janë tepër të përgjithshme, tingëllojnë gati njësoj, thua se partitë nuk i përkushtojnë energji dhe resurse zhvillimit të tyre.

Partitë politike kanë filluar të shfaqin disa etiketa ideologjike, edhe pse ato nuk janë me rëndësi të veçantë për qëndrimet e anëtarësisë. Lidhja Demokratike është anëtare e Partisë Popullore Evropiane (EPP) të qendrës së djathtë për shumë vite; Lëvizja Vetëvendosje është parti e majtë, por mban pozita nacionaliste; ndërsa është e vështirë për të dalluar qëndrimet e partive të tjera. Sa janë efektive partitë politike në komunikimin e ideologjive dhe prioritetëve të platformave për anëtarët e tyre është një shqetësim tjetër. Drita Gjeli, konsulente e pavarur, vlerëson se partitë politike nuk bëjnë përpjekje të mjaftueshme për të shtrirë aktivitetin deri anëtarët e tyre.⁵⁵

Instituti Demokraci për Zhvillim (D4D) në studimin e vet *Busolla ideologjike e Kosovës* shpjegon se si liderët e partive politike nuk lodhen që të etiketojnë një ideologji për një politikë të veçantë.⁵⁶ Është e vështirë për të inicuar reformë në këtë drejtim pasi që, parimisht, ideologjitë kundërshtojnë politikat sporadike të

cilat janë më të përshtatshme për t'i dalë ndesh interesave nga lart.⁵⁷ Nuk është për t'u befusuar pse partitë politike nuk ushqejnë ideologji të përkufizuara mirë. Partitë në masë të madhe mbështeten në besnikërinë e elektoratit të tyre të përcaktuar nga një varg dinamikash krahas përfitimeve personale, të cilat përfshijnë: lokacionin gjeografik, miqësinë dhe familjen.⁵⁸

Por, madje edhe brenda partive politike, idetë dhe perceptimet janë aq të larmishme dhe kundërtënjese, sa që e bëjnë të vështirë për t'i vënë në korniza të kategorive ideologjike. D4D përmbledh gjetjet e veta si në vijim: 2/3 e zyrtarëve të partisë janë të majtë dhe konservatorë, ndërsa 1/3^{ta} e zyrtarëve të partisë janë mendjehapur sa i përket vlerave shoqërore dhe personale.⁵⁹ Lëvizja Vetëvendosje është e majtë në lidhje me ekonominë, konservatore në çështjet e identitetit, dhe liberale në kuptim të lirive personale. D4D argumenton se politikat nuk e përcaktojnë orientimin e partisë, dhe se partitë politike janë po aq të larmishme nga brenda.⁶⁰

PATRONAZHI POLITIK

Në Kosovë, partitë politike janë themeluar si përgjigje ndaj nevojave dhe përpjekjeve për formimin e një shteti të pavarur. Mirëpo, këto nevoja janë kthyer në një dëshirë të fortë për dobi pasurore dhe interesa personale, dhe kështu, i kanë transformuar partitë në *mjet për të fituar pushtet* në dëm të interesit publik.⁶¹ Si rezultat i kësaj, partitë politike kanë distancuar veten nga elektorati i përgjithshëm, duke arsyetuar kështu mungesën e entuziazmit për të mbështetur ose për të votuar partitë politike - një tipar i përbashkët që ekziston në shumë vende të Evropës Lindore.⁶²

54 Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave (KIPRED). Sistemi zgjedhor dhe partiak në Kosovë. 2015, f. 10.

55 Gjeli, Drita. Eksperte e pavarur. Intervistë. 24 tetor 2016.

56 Malazogu, Leon & Brenna Gautam. Instituti Demokraci për Zhvillim (D4D). *Busolla Ideologjike e Kosovës*. 2014, f. 11.

57 Malazogu, Leon & Brenna Gautam. Instituti Demokraci për Zhvillim (D4D). *Busolla Ideologjike e Kosovës*. 2014, f. 10.

58 Malazogu, Leon & Brenna Gautam. Instituti Demokraci për Zhvillim (D4D). *Busolla Ideologjike e Kosovës*. 2014, f. 9.

59 Malazogu, Leon & Brenna Gautam. Instituti Demokraci për Zhvillim (D4D). *Busolla Ideologjike e Kosovës*. f. 5.

60 Malazogu, Leon & Brenna Gautam. Instituti Demokraci për Zhvillim (D4D). *Busolla Ideologjike e Kosovës*. 2014, f. 5.

61 Malazogu, Leon & Brenna Gautam. Instituti Demokraci për Zhvillim (D4D). *Busolla Ideologjike e Kosovës*. 2014, f. 8.

62 Lewis, Paul G. *Political Parties in Post-Communist Eastern Europe*. Routledge. 2000, f. xl.

Pse qytetarët janë aq të zhgënjyer mund të shpjegohet duke përdorur dilemën principal-agjent, sipas të cilës një parti politike (agjenti) vepron në kundërshtim me interesat e elektoratit të saj (principi). Në vend që të përfaqësojnë zgjedhësit e tyre, partitë politike i shkojnë pas grupeve të interesit dhe militantëve nga të cilët varen për mbështetje. Në këtë rast, është vështirë për të bërë dallim midis partive politike dhe grupeve të interesit, ku këto të fundit janë të prira për të formësuar agjendën politike duke marrë parasysht qasjen e tyre më të madhe në resurse financiare dhe njerëzore.

Partitë politike janë të prira për të përfaqësuar interesat e disave, mbështetës dhe militantë të tyre, nga të cilët ata kërkojnë përfitime në këmbim. Për këtë arsye, partitë nuk janë agjentët më të mirë, të cilët ndihmojnë që idetë të shndërrohen në ligje dhe politika në emër të interesit publik. Në këtë kuptim, zgjedhësit janë të pa përfaqësuar, nëse jo të shfrytëzuar, përveç nëse ata përcaktohen për të hyrë në ndonjë marrëveshje me një parti politike me qëllim të përfitimit të ndonjë dobie pasurore - një rezultat nën optimal që kërcënon mirëqenien e përgjithshme publike.

Në këtë rast, agjenti ka shumë pushtet diskrecionar dhe shtysë të madhe për ta shfrytëzuar atë në mënyrë që të maksimizojë interesat e veta private.⁶³ Devijimi nga interesat e principit çon në shpenzimet të agjencisë nëpërmjet të kërkimit të qiradhënies dhe fitimit. Partitë politike angazhohen në kërkim të qiradhënies për të kontrolluar institucionet publike për të mbajtur pushtetin politik nga i cili do të përfitojnë udhëheqësit apo partia në aspektin e votave në zgjedhjet e ardhshme. Kërkimi i fitimit përdoret nga partitë më shumë për qëllime të krijimit të pasurisë duke i dhënë kontratat për kompanitë që financojnë partinë.

Është e qartë deri tani se zgjedhësit mbështetin partitë e caktuara politike kryesisht për qëllime të përfitimeve personale në vend të bindjeve politike. Shtysat janë të mëdha meqenëse sektori publik është punëdhënësi më i madh në vend me pothuajse 90,000 zyrtarë që punojnë në institucionet publike. Kjo ofron mundësi për partitë politike për të ushtruar kontrollin e tyre politik duke ndikuar vendimet në aspektin e punësimit.⁶⁴ Preportr, Qendra Kosovare për Gazetari Hulumtuese, pohon se partitë politike për çdo përkrahje që marrin, shpërblejnë

përkrahësit apo *klientët* e tyre me përfitime të punësimit, gjetje që mbështetet edhe nga studime të tjera të patronazhit politik, përfshirë edhe atë të kryer nga D4D.

Partitë politike angazhohen në aktivitete klienteliste të shkëmbimit të mallrave dhe shërbimeve për të fituar mbështetje politike. Parimi i dilemës principal-agjent qëndron në zemrën e një sistemi të korruptuar politik, në të cilin klientët përkufizohen si grupe të interesit apo kompani që marrin shpërblime nga partitë politike në formë të kontratave të prokurimit. Transaksionet mes tyre jo vetëm që janë të turbullta dhe nuk raportohen, por shpesh janë të përcjella me shkelje të vazhdueshme të Ligjit për Financimin e Subjekteve Politike. Preportr, me porosi nga KQZ-ja, duke shoshitur nga afër raportet e auditimit ka identifikuar një listë të donacioneve që janë gjetur të jenë të paligjshme për tejkalim të pragut vjetor prej 10,000 Euro.⁶⁵

Thuhet se, udhëheqësit e partive politike dhe/ose të afërmit e tyre janë aksionarë në shumë kompani të cilat janë nënkontraktuar nga qeveria. Kjo është diçka që Preportr e ka raportuar në një studim hetimor të kryer në vitin 2012 për të analizuar burimet e financimit të partive politike në krye të qeverisë. Nga dokumentet zyrtare të marra në terren, Preportr ka identifikuar 43 kompani lokale që kanë financuar Partinë Demokratike të Kosovës në zgjedhjet e vitit 2009 dhe 2010 të cilat janë shpërblyer me kontrata të prokurimit prej 100 milionë Euro.⁶⁶

Përfaqësimi i interesave është një sfidë dhe synim afatgjatë që partitë politike duhet ta trajtojnë si prioritet duke e bërë atë më përfshirës dhe më përfaqësues të interesit të përgjithshëm publik. Kjo do të kërkojë një mendësi më ndryshe të përshtatur drejt një baze më të gjerë të elektoratit dhe ideologjive të caktuara dhe jo drejt një grupi të ngushtë të mbështetësve dhe interesit vetjak. Reforma në këtë drejtim është pak e besueshme tani për tani, pasi që gjendja e tanishme është aq e pafavorshme. Partitë zbatojnë platforma të improvizuara politike dhe janë shumë egocentrike.

63 Hamilton, Alexander. Small is Beautiful, at Least in High-Income Democracies. World Bank. January 2013, f. 2.

64 Boletini, Besnik. Partia e Punës. <http://preportr.cohu.org/en/investigations/65> [Qasur më 17 tetor 2016].

65 Besa, Kalaja. Merr Jep. <http://preportr.cohu.org/en/investigations/158> [Qasur më 9 shtator 2016].

66 Duriqi, Visar & Qëndrim Bunjaku. 100 milionë. <http://preportr.cohu.org/en/investigations/53> [Qasur më 19 tetor 2016].

ZGJIDHJET PËR PROBLEMET

Ky punim mbyllet me përfundimin se partitë politike ngecin pra-pa sa i përket integritetit dhe qeverisjes institucionale. Me pak fjalë, ato (i) nuk janë kompetente dhe mjaftueshëm të gatshme për të përfaqësuar zgjedhësit e tyre, (ii) nuk janë të pavarura nga mbështetja e jashtme financiare, dhe (iii) nuk janë institucione llogaridhënese dhe transparente ndaj publikut. Përmirësimi dhe kapërcimi i problemeve të identifikuara, kërkon një kornizë të zgjidhjeve të krijuar enkas dhe përpjekje afatgjata për zbatimin e tyre.

Ideja themelore është që partitë politike të shndërrohen nga oportunistë në vullnetarë në mënyrë që ato t'i përgjigjen kërkesave të zgjedhësve të tyre në mënyrën e duhur. Gjithsesi, kjo nuk është diçka që mund të arrihet me këtë dokument, i cili duhet të trajtohet më shumë si një burim për hartimin e strategjive dhe programeve pro-integritetit në sferën politike. Pa iniciativën e partive politike për t'u përmirësuar, reforma kundër-korrupsion do të jetë pothuajse e pamundur.

Janë të paktën dy forma të promovimit të integritetit në partitë politike. Njëra është përmes ndryshimeve në legjislacion, dhe tjetra përmes avokimit duke ndarë ndryshimet në praktikë.

NDRYSHIMET NË LIGJ

Reforma partiake duhet të bëhet prioritet përgjatë të cilit do të përshtatet një ligj specifik për partitë politike për të trajtuar procedurat demokratike brenda partisë. Disa nga dispozitat e tjera të cilat duhet të merren parasysht përfshijnë si në vijim:

- Ligji i ri, ose ndryshimet e tjera ligjore duhet të përcaktojnë statusin e partive politike dhe të vendosin mekanizmat e llogaridhënies dhe konkurrencës së shëndoshë.
- Kufizimet financiare nuk duhet të vendosen vetëm për kontributet, por edhe në shumën e shpenzimeve dhe në çka mund të shpenzohen paratë (përtej fushatës zgjedhore).

- Komisioni i Zgjedhjeve duhet të kufizohet nga aspekti i drejtitimit nga gjyqtarët, duke e bërë atë një institucion apolitik dhe duhet t'i jepet një rol më hetues në mbikëqyrjen e financave partiake.
- Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), ose ndonjë institucioni tjetër kompetent të pavarur duhet t'i jepet autoriteti për të kontrolluar partitë politike.

NDRYSHIMI NË PRAKTIKË

Nuk ka një grup të vetëm dhe të veçantë të praktikave më të mira për qeverisjen brenda partisë. Liderët e secilës parti politike duhet të marrin në konsideratë efektet praktike të demokracisë së brendshme.

- Partitë forcojnë procedurat e tyre të brendshme demokratike me zgjedhjen e kandidatëve dhe duke përfshirë më shpesh anëtarët në vendimmarrje.
- Zyra e KQZ-së duhet të ushtrojë një rol më proaktiv dhe hetues në auditimin e aktiviteteve financiare të subjekteve politike.
- Liderët e partive politike duhet të bien dakord për të bërë Betimin e Integritetit, duke u zotuar kështu për të ndërmarrë reforma serioze partiake duke filluar me vënien e raporteve të tyre financiare në dispozicion të publikut.
- Kuvendi i Kosovës me anë të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike duhet të marrë masa të menjëhershme për të inicuar procesin e auditimit të partive politike.

SHTOJCAT

SHTOJCA 1: SHQYRTIMI I LITERATURËS

Ky punim përbashkon studimet nga një varg i burimeve lokale dhe ndërkombëtare për të fituar një perspektivë më të gjerë rreth çështjes tematike. Me qasjen e saj shumëdisiplinore, ai ka për qëllim të kontribuojë në fushën e integritetit dhe partive politike. Burimet e listës së ngushtë të literaturës të përdorura për të shqyrtuar çështjet e integritetit dhe për të nxjerrë praktikatat më të mira janë paraqitur në nën-pjesët e mëposhtme.

Burimet vendore

Punimi kërkimor është formësuar nga shumë studime të kryera nga organizatat lokale. D4D, në kontekstin lokal, ka përvajë të gjerë kërkimore rreth ideologjisë partiake dhe përfaqësimit të interesave. ÇOHU është një organizatë aktive e shoqërisë civile e cila merret me avokim dhe punë hetimore lidhur me aktivitetet financiare të partive politike. KIPRED si një institut think-tank është më shumë i shqetësuar në lidhje me aspektet teorike dhe praktike të integritetit të sistemit zgjedhor dhe partive politike.

Duriqi, Visar & Qëndrim Bunjaku. ÇOHU. 100 milionë. Prill 2012.

Duriqi dhe Bunjaku raportojnë mbi marrëdhëniet klienteliste ndërmjet Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) dhe komunitetit të biznesit. Një llogaritje e thjeshtë matematikore e bazuar në raportet zyrtare të auditimit të fushatave zgjedhore lokale dhe kombëtare (2009-2010) tregon se si 43 kompani lokale e kanë financuar PDK-në me rreth 280,000 Euro. Në këmbim, ato janë shpërblyer me 100 milionë para të tenderëve. Partitë e tjera politike janë vënë në qendër të vëmendjes nga Preportri në disa artikuj të tjerë, duke përfshirë edhe artikullin *Merr Jep* nga Besa Kalaja dhe botuar në prill të të njëjtit vit.

Boletini, Besnik. ÇOHU. Partia e punës. Dhjetor 2014.

Preportri ka kryer një studim kërkimor për të vlerësuar shkallën e *patronazhit politik* në institucionet publike. Ky kërkim empirik mbulon të dhënat zyrtare të marra nga terreni në periudhën kohore mes vitit 2010 dhe 2014. Të dhënat e analizuara tregojnë se punësimi në sektorin publik është në masë të madhe i ndërlic-

hur me partitë politike. Preportri ka identifikuar 249 funksionarë të rangut të lartë që janë të lidhur me parti të caktuara politike për periudhën përkatëse kohore.

Malazogu, Leon & Brenna Gautam. (D4D). Busolla Ideologjike e Kosovës. 2014

D4D-ja ka publikuar një studim kërkimor mbi ideologjinë partiake në Kosovë. Ajo hartëzon ideologjitë partiake nëpërmjet 40 pyetjeve që i janë shtruar 160 zyrtarëve partiakë në përpjekje për të matur shkallën në të cilën partitë politike anojnë në të majtë apo të djathtë. KDI-ja ka konsultuar këtë punim për të kuptuar më mirë në qoftë se partitë politike janë idealiste. Gjetjet e punimit do të ndihmojnë që ky dokument të vejë në dyshim hipotezën e vet, se partitë politike janë mendjengushta për shkak të mungesës së ideologjisë dhe të menduarit vetëm në aspektin e interesave të tyre në vend të interesave të zgjedhësve të tyre.

Pula, Erza. GLPS. Standardet për Financimin e Partive. Qershor 2014.

GLPS-ja në këtë raport të politikave jep një pasqyrë të standardeve që kanë të bëjnë me financimin e partive politike në Kosovë. Financimi i partive është i rëndësishëm për demokracitë në tranzicion. Znj. Pula, si krye-hulumtuese në GLSP dhe autore e studimit, argumenton për grup të standardeve të cilat janë të rëndësishme për të garantuar transparencë të rritur në financimin e partive. Ato janë të rëndësishme në Kosovë, ku financimi i partive është bërë shqetësim i madh në tre vitet e fundit.

KIPRED. Sistemi Zgjedhor dhe Partiak në Kosovë. 2015.

Në vitin 2015, Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave (KIPRED) ka kryer një analizë kërkimore të sistemit zgjedhor dhe partiak në Kosovë. Për qëllime të këtij punimi kërkimor, KDI-ja ka shqyrtuar Kapitullin II dhe IV që përqendrohen më shumë në sistemin partiak dhe demokracinë e brendshme. Kapitulli II jep një pasqyrë të zhvillimit dhe funksionimit të partive politike në pluralizëm që nga rënia e komunizmit. Kapitulli IV diskuton strukturat e brendshme organizative dhe procesin vendimmarrës të partive politike.

KIPRED. Politikëbërja dhe Vendimmarrja në Partitë Politike. 2015.

Ky studim i shkurtër shqyrton edhe procesin e politikëbërjes edhe atë të vendimmarrjes të partive politike për përfaqësimin e interesave të grave, të rinjve dhe pakicave etnike në nivel parlamentar. Gjetjet kryesore bazohen në kërkimin në tavolinë të statuteve dhe programeve të partive dhe një sërë intervistash me udhëheqësit e partive. Rrjedhimisht, sa përfaqësuese dhe gjithëpërfshirëse janë partitë politike ndaj këtyre grupeve në fund të fundit varet nga autoriteti i udhëheqësve.

Burimet ndërkombëtare

Burime të shumta ndërkombëtare kanë ndihmuar që të kuptohet integriteti i partive politike, që ende paraqet temë të re kërkimore për eksplorim në botën akademike. Në thelb, ato janë më shumë akademike dhe teorike. Në veçanti, ato kanë ndihmuar në formësimin e strukturës dhe përmbajtjes së dokumentit për diskutim duke u përpjekur për ta bërë atë më tërheqës për një audiencë më të gjerë të lexuesve, dhe jo domosdoshmërisht vetëm për partitë dhe udhëheqësit politikë.

Pope, Jeremy. The Elements of a National Integrity System. 2000.

NIS-i është projektuar si një metodologji hulumtuese nga Jeremy Pope, ish-drejtor i Transparency International (TI). Nga shumë njerëz, konsiderohet si libër/burim standard për çështjet e integritetit nga aspektet e të gjitha institucioneve. Modeli NIS ka ndihmuar që ky punim të vejë theksin në masat e qeverisjes së mirë dhe ndryshimin e sjelljes që lypset për reformë kundër-korrupsion. KDI-ja ka vënë fokus të veçantë në lidhjet mes partive politike dhe institucioneve të tjera për të kuptuar më mirë rolin e tyre në jetën politike. Në fakt, korniza logjike e punimit është shkruar sipas modelit NIS.

Sagar, D.J. Edited. Political Parties of the World. JHP. 7th Edition. 2009.

Ky libër i shkruar në formën e enciklopedisë ofron informacione të vyeshme dhe të besueshme mbi zhvillimet partiake në të gjithë globin. Edhe pse është një botim i vjetër, ai megjithatë ka ndihmuar që punimi të hartëzojë një përmbledhje të përgjithshme historike mbi partitë politike dhe të bëjë ndër krahasim me informacion aktual. Është gjithëherë interesante për të analizuar se si burimet ndërkombëtare paraqesin hisetarët dhe situatat politike në një kontekst lokal.

Hofmeister, Wilhelm & Karsten Grabow. Political Parties. KAS. 2011.

Ky libër jep një pasqyrë të asaj se si funksionojnë partitë politike në demokracitë moderne duke hedhur vështrim mbi karakteristikat, elementet dhe problemet kryesore në funksionimin e brendshëm të partive. Ai ka arritur qëllimin e vet për këtë punim me ngritjen e interesit dhe shtrirjen e kontributit në fushën e zhvillimit partiak. Së fundi, Hofmeister dhe Grabow sigurojnë një burim të jashtëzakonshëm për reformat partiake të cilin do të duhej ta shqyrtojë çdo studiues.

Hooghe, Marc & Anna Kern. What is so special about Party Membership? 2003.

Hooghe & Kern ekzaminojnë lidhjet mes zgjedhësve dhe partive politike. Gjetjet kryesore të këtij dokumenti kërkimor tregojnë se nuk ka asnjë arsye që besimit politik t'i atribuohet niveli i anëtarësisë. Ndjenja e afërsisë me një parti politike është atribuim shumë më i fortë kur është fjala për besimin politik se sa për anëtarësi. Ky dokument sugjeron që partitë duhet të shtrijnë më shumë veprimtarinë e tyre deri te zgjedhësit apo anëtarët e rinj dhe të mos përqendrohen vetëm në rrethin e anëtarëve të tyre.

Uberoi, Elise. Political Party Funding: Sources and Regulations. HCL. 2016.

Ky dokument referues paraqet burimet kryesore të financimit të partive politike dhe rregullat të cilat aplikohen për përdorimin e tyre në Mbretërinë e Bashkuar. Ai diskuton se si zbatohen rregullat për partitë politike dhe kandidatët, si dhe për shpenzimet dhe financimin e palëve të treta gjatë fushatave zgjedhore.

SHTOJCA 2: BETIMI I INTEGRITETIT

Ky betim i integritetit i përvetësuar nga **Iniciativa e Integritetit** është një shprehje formale dhe konkrete e zotimit nga ana e partive politike për të respektuar rregullat etike dhe për të mbështetur përpjekjet kundër-korrupsionit. Betimi duhet të nënshkruhet vetëm nga liderët e partive politike. Duke nënshkruar betimin e integritetit, partitë politike do të gëzojnë mirënjohje edhe nga publiku edhe nga anëtarësia e tyre.

Unë besoj se korrupsioni paraqet një nga pengesat më të mëdha për rritjen dhe prosperitetin në Kosovë. Si udhëheqës i një partie politike, pranoj përgjegjësinë time për të prirë si shembull në luftën kundër korrupsionit. Kjo luftë nuk mund të ketë sukses pa angazhimin tonë për të barazuar nivelin e fushëlojës dhe për të ndërtuar integritetin në partitë politike.

Duke pasur parasysh sa më sipër, unë betohem për sa vijon:

- Krijimin e një procesi vendimmarrës më gjithëpërfshirës në të cilën të gjithë anëtarët kanë të drejta të barabarta në mënyrë që politikat të pasqyrojnë kërkesat e elektoratit.
- Respektimin dhe zbatimin e kodit të sjelljes për të drejtuar anëtarët për sjellje etike dhe llogaridhënese në çdo kohë.
- Kryerjen e programeve për ndërtimin e kapaciteteve për të promovuar integritet dhe llogaridhënie në ushtrimin e detyrave dhe përgjegjësi të tyre.
- Zbatimin e kontrolleve të duhura për të parandaluar sjelljen jo-etike nga anëtarët tanë, dhe për të garantuar qeverisje të mirë.
- Sigurimin që raportet tona financiare janë të sakta, të përditësuara dhe të publikuara në uebsajtin tonë për qëllime të informimit publik.

Në mënyrë që të garantohen veprime kolektive për të nxitur reformën kundër-korrupsion në vend, unë zotohem për:

- Mbështetjen e nismave dhe strategjive në luftën kundër korrupsionit.
- Angazhimin në reformën zgjedhore për të krijuar një kornizë më të plotë ligjore.
- Pjesëmarrjen në diskutime, takime dhe forume për të identifikuar çështjet e integritetit.
- Ndarjen e praktikave më të mira të destinuara për të ndihmuar nismat e integritetit.
- Caktimin e masave dhe aktiviteteve kyçe të kontrollit për të siguruar integritet.

Emri i nënshkruesit

Data e nënshkrimit

Nënshkrimi

Pozita

Partia politike

Bashkimi Evropian është i përbërë nga 28 Shtete Anëtare të cilat kanë vendosur ti vejnë bashkë njohuritë, kapacitetet dhe fatin e tyre. Së bashku, në procesin e zgjerimit gjatë 50 viteve, ato kanë arritur të ndërtojnë stabilitet, demokraci dhe zhvillim të qëndrueshëm duke promovuar llojlojshmëri kulturore, tolerancë dhe liri individuale. Bashkimi Evropian është i përkushtuar për ti ndarë arritjet dhe vlerat e tij me shtetet dhe popujt jashtë kufijve.